



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 2407 /2025
Data : 10.04.2025

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e tretë -III- për vitin 2025 e Komitetit për Politik dhe financa, mbajtur me datë 12.03.2025 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoreshë për Kulturë , Rini dhe Sport), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Kimete Kuka - Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Rezart Mehmeti** (Përfaqësues i OSB-së), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Propozim vendim për hapjen e debatit publik për Draft Planin Zhvillimorë të Komunës Hani i Elezit 2025-2033.
3. Propozim vendim për shqyrtimin e raportit të studimeve dhe evidentimit të vlerave të trashëgimisë natyrore në teritorin e Komunës së Hanit të Elezit të propozuara nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.
4. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2024.
5. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2024.
6. Informatë për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2024.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- pika e gjashta e rendit të punës është e njëjtë me pikën e pestë dhe në vend të informatës mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre të përmirësohet dhe të jetë Raporti financiar për vitin 2024 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë vërejtje sa i përket procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Propozim vendim për hapjen e debatit publik për Draft Planin Zhvillimorë të Komunës Hani i Elezit 2025-2033.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- propozim vendimi ka të bëjë me hapjen e debatit publik për Draft Planin Zhvillimorë pas marrjes së pëlqimit nga Ministria përkatëse se PZHK-ja është në pajtim me planin hapësinorë si dhe është vlerësuar se është hartuar në pajtim me udhëzimin administrativ se çka duhet të përmbajë plani zhvillimorë komunal. Komuna obligohet që të mbajë debat publik dhe debati publik zgjat tridhjetë ditë, pastaj duhet dy javë ditë që të bëhet hartimi i raportit nga debat publik. Dokumenti përsëri kthehet në Ministri për marrje të pëlqimit final dhe hapi i fundit është miratimi në Kuvendin e Komunës .

Sherif Berisha thekson:- kërkoj një kronologji për çështjen e këtij plani dhe kush janë autorët që e kanë hartuar këtë plan.

Nexhmedin Daci thekson:-jemi vonuar në hartimin e PZHK-së pak për arsye objektive dhe subjektive. Vendimi i parë është marr në vitin 2020 por ju e dini që në vitin 2020-2021 ka qenë kovidi , takimet kanë qenë pothuajse të pamundura. Në vitin 2022 kanë ardhur zgjedhjet e reja. Fillimisht ka qenë i angazhuar z.Sami Stagova po për arsye shëndetësore kështu që ka pasur vonesa. Në kohët të fundi për draftin final e kemi angazhuar një eksperte të jashtme nga Prizreni znj.Dafina Karahoxha, po ashtu si ekspert i jashtëm për hartat ka punuar edhe z.Printim Asllani. Draftin në muajin Gusht e kemi përcjell për Ministri për shkak se ashtu precizohet me Ligj. Fillimisht e kemi pasur prezantimin në Ministri para komisionit dhe kanë dhënë rekomandimet, i kemi plotësuar dhe e kanë dhënë pëlqim për debat publik. Në grup punues kanë qenë të gjithë drejtorët dhe zyrtarë komunal. Në vitin 2021 është mbajtur një punëtori tre ditore në Radikë për planin zhvillimorë, e që të pranishëm kanë qenë të gjithë përfaqësuesit e partive politike, po ashtu secilin që kemi menduar që mundet me dhënë kontribut e kemi ftuar pra nuk ka pasur dallime politike. Sa i përket çmimit ky lloj dokumenti kushton diku afër 70 000 €, mirëpo kur është marr vendimi me hartuar këtë plan është angazhuar z.Sami Stagova me kontratë në vepër dhe është paguar 3600 €, znj.Dafina Karahoxha është paguar 3000 € kemi edhe pak obligime financiare ndaj sajë, z.Printim Asllani 1800 € dhe shpenzimet operative që i kemi pasur. Dokumenti mund të plotësohet edhe gjatë debatit publik.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PROPOZIM VENDIMI PËR HAPJEN E DEBATIT PUBLIK PËR DRAFT PLANIN ZHVILLIMORË TË KOMUNËS HANI I ELEZIT 2025-2033 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Propozim vendim për shqyrtimin e raportit të studimeve dhe evidentimit të vlerave të trashëgimisë natyrore në territorin e Komunës së Hanit të Elezit të propozuara nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

Nexhmedin Daci thekson:- propozim vendim për shqyrtimin e raportit të studimeve dhe evidentimit të vlerave të trashëgimisë natyrore në territorin e Komunës së Hanit të Elezit të propozuara nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Komuna jonë së bashku me institutin e natyrës kanë punuar po thuaj se tetë muaj ditë në identifikimin e vlerave natyrore të cilat do të propozohen për mbrojtje ligjore. Instituti ka hartuar një raport dhe një elaborat dhe në bashkëpunim me komunën janë përzgjedhur pesë vlera të trashëgimisë kulturore në komunë tonë prej tetëve sa kanë qenë në listën e propozimeve, e para është Parku dhe Ujëvara pra ky monument është me karakter hidrologjikë, Kanioni në fshatin Dermjak pra monument natyrorë me karakter hidrologjikë, Trungu i Bungëbutes (*Quercus pubescens*) në fshatin Dermjak që është një lis i vjetër 350 vite, Trungu i Bungëbutës (*Quercus pubescens*) në fshatin Gorancë i cili e ka një lartësi prej trembëdhjetë deri në pesëmbëdhjete metra, perimetrin tre metra, kurora dhjetë metra, Kepi i gjatë dhe burimi i ujit në fshatin Pustenik. Procedurat për përzgjedhjen e këtyre monumenteve parashihet që me hapur debat publik dhe pas debatit publik duhet të bëhet një kërkesë në Ministri për marrjen e pëlqimit dhe pastaj me vendim të Kuvendit të Komunës shpallen si vlera të trashëgimisë kulturore.

Hyriete Isufi thekson:- nëse parku dhe ujëvara shpallen objekte të trashëgimisë natyrore a mundemi me i ruajtur ashtu siç janë për shkak se policia është afër për me u zhvendosur në objektin e ri dhe është pak problem sepse mundet me u dëmtuar. Si ide mu duke e mirë që mundësisht me u ruajtur diçka prej natyrës sepse është tu bërë vetëm asfalt apo cement.

Nexhmedin Daci thekson:- në momentin që shpallet një objekt i trashëgimisë kulturore në mbrojtje ligjore përcaktohen edhe kufijtë e asaj pjese dhe institutit i mbetet për mi përcaktuar kufijtë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PROPOZIM VENDIMI PËR SHQYRTIMIN E RAPORTIT TË STUDIMEVE DHE EVIDENTIMIT TË VLERAVE TË TRASHËGIMISË NATYRORE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT TË PROPOZUARA NGA INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:-pse nuk kanë marr pjesë në takime personat adekuat dhe çdo kund shënon se në pikën dy apo tre në bazë të këtij materiali nuk kemi mundur me vazhduar për shkak të mungesës apo personave të cilët kanë qenë përgjegjës, pra në secilën mbledhje ka pasur mungesë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- në material janë të shënuara pikat të cilat janë diskutuar në këshillin komunal për siguri në bashkësi, takimet mbahen çdo dy muaj. Përveç materialit që e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Hyriete Isufi thekson:- për dëmtimet të cilat janë bërë te parket a është ndërmarr diçka apo a është dënuar dikush. Personat të ndryshëm që lëvizin nëpër park me motorra është mirë me ndërmarr veprime ndaj tyre policia.

Mehmet Ballazhi thekson:- nuk është dënuar askush edhe pse ka pasur kërkesa për me dënuar por qëllimi është i vetëdijesimit. Te parku “Isa Berisha” jemi duke pritur përfundimin e projektit të ashensorit në shkollë dhe janë disa anësore për mi marr dhe kemi bërë një karrik sa ne pa se si duket dhe besojë që do të jetë më vështirë për me u prishur për shkak mekanizmave që do të vendosen, pra do të merren veprime për me i riparuar.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATA PËR AKTIVITETE E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Informatë për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- për vitin 2024 janë mbajtur gjashtë takime me këshillat e fshatrave. Përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Sherif Berisha thekson:- kam një shqetësim nga këshillat e fshatrave për shkak se nuk po ju kryhet pagesa.

Natyra Kalisi thekson:-këshillat e fshatrave janë paguar për gjashtë mbledhje.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PËR AKTIVITETE E KËSHILLAVE TË FSHATRAVE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:-me çështjen e dritave nuk e di se çka është duke ndodhur. Leja që i është dhënë për tre muaj për kioskën e akulloreve, si është puna a ju është vazhduar. A është përcaktuar komisioni i bursave dhe sa është numri i aplikusve për bursa.

Arsim Dernjani thekson:- sa i përket ndriçimit të premtën bëhet hapja e tenderit, ndërsa për çështjen e kioskës duhet me bërë kërkesë për me vazhduar.


Hisni Luri thekson:-komisioni i bursave është në finalizim , ndërsa sa i përket aplikantëve për bursa janë shtatëdhjetë e dy aplikantë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 11:42.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi

Për


Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

